

# PYETJET E HISTORISE SE ARTIT

## Departamenti i Arteve të Aplikuara

Pyetjet janë të ndara në numra rendor dhe çdo numër përmban tre nënpyetje:

**a** - Nga historia e artit botëror

**b** – Nga historia e artit shqiptar

**c** - Nga specialiteti i zgjedhur

Pyetjet shërbejnë për njërën nga fazat e konkursit të pranimit të studentëve në Universitetin e Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura. Krahas konkurimit praktik në pikturë, skulpturë dhe vizatim, studenti testohet edhe teorikisht për njohuritë e tij rreth Historisë së Artit botëror, shqiptar me specifikisht mbi specialitetin e përzgjedhur.

Pyetjet shërbejnë si një orientim fillestar në bashkëbisedim. Anëtarët e komisionit kanë të drejtë të bëjnë dhe pyetje shtesë kur ata e shohin të nevojshme.

Secili student tërheq pyetjet dhe përgjigjet në prani të komisionit. Studenti ka të drejtë të tërheqë pyetjet deri në dy herë.

...

## PYETJET PËR PROGRAMIN TEKSTIL DHE MODË:

### Teza 1

- a. Flisni për *Artin antik Grek* dhe për periudhat që e përbëjnë atë. Ndaloni më gjatë në njërën prej tyre.
- b. Flisni për karakteristika e *Arti Pasbizantin* ne Shqipëri. Përmendni disa piktorë shqiptarë pasbizantin.
- c. Përmendni një stilist bashkohor që pëlqeni. Flisni për karakteristikat që e bëjnë punët e tij të dallueshme nga stilistët e tjerë.

### Teza 2

- a. Flisni për Artin në *Egjyptin e Lashtë* dhe për civilizimet që ndikoi ai?
- b. Cilët janë fotografët *Marubi*. Vlera e punës së tyre.
- c. Flisni për *Coco Chanel*, stili veshjeve të saj dhe risitë që sjell ajo në modën e shekullit të 20-të.

### Teza 3

- a. Flisni për artin *Bizantin* dhe tiparet e tij. Përmendni dhe komentoni dy vepra nga arkitektura apo arti i kësaj periudhe.
- b. *Amfiteatri i Durrësit*. Periudha e ndërtimit, historia e tij.
- c. Flisni për *Veshja popullore shqiptare*. Ndarja në treva kryesore. Karakteristikat dhe dallimet kryesore ndërmjet tyre.

#### Teza 4

- a. Flisni për artistin italian *Mikelanxhelo*. Kur jetoj ai dhe për cilat vepra është i famshëm. Flisni më gjatë për një të një prej tyre.
- b. Çfarë dini për veshjet popullore shqiptare. A u bënë ato burim frymëzimi për krijimtarinë artistike të artistëve evropian dhe kur?
- c. Cila është sfilata e fundit që keni parë. Komentoni atë dhe vlerat që ajo përcillte.

#### Teza 5

- a. Çfarë është *Stili Gotik*. Periudha kohore dhe tipare të këtij stili. Përmendni dhe komentoni dy vepra nga arkitektura apo arti i kësaj periudhe.
- b. Çfarë janë „*Kodikët*“. Flisni më gjatë për Kodikun e Purpurt të Beratit dhe rëndësinë e tij.
- c. Flisni mbi një nga *shtëpitë më të vjetra të modës europiane*.

#### Teza 6

- a. Kohëzgjatja dhe tipare të *Rilindjes Italiane*. Përmendni dhe komentoni disa personalitete të kësaj periudhe.
- b. „*Realizmi Socialist*“ në Shqipëri. Tipare të kësaj rryme. Komentoni një vepër tipike të Realizmit Socialist Shqiptar.
- b. Flisni për artin e modës sot në Shqipëri. Përmendni disa stilistë të famshëm që ju njihni.

## Teza 7

- a. Flisni për Ekspresionizmin Abstrakt. Tiparet, artistë dhe vepra të këtij stili.
- b. Flisni mbi ardhjen dhe zhvillimin e *fotografisë në Shqipëri*.
- c. Përmendni disa stilistë të njohur shqiptarë dhe komentoni më gjerë punën e njerës (-it) prej tyre.

## Teza 8

- a. Çfarë kuptoni me termin Impresionizëm. Flisni për rëndësinë e kësaj periudhe artistike dhe për disa nga protagonistët e saj .
- b. Flisni mbi jetën dhe veprën e *Kol Idromenos*. Analizoni e komentoni pikturën e tij “Motra Tone”.
- c. Përmendni dhe komentoni dy vepra artistike (piktura apo skulptura), ku veshja është element i rëndësishëm në mesazhin e paraqitjes.

## Teza 9

- a. Citoni disa rrymat dhe *stilet artistike të shek. XX*. Shpjegoni më gjerë njerën prej tyre si dhe dy vepra nga rryma e zgjedhur.
- b. Çfarë dini rreth piktorit Onufri? Ku u zhvillua vepra e tij dhe çfarë risish kishte ajo për kohën?
- c. Përmendni disa forografë mode dhe komentoni më gjerë njerën (-in) prej tyre.

## **Teza 10**

- a. Flisni për piktorin e njohur Rembrand. Komentoni një vepër nga ky artist.**
- b. Citoni tre vepra të skulptorit *Odhise Paskali* dhe analizoni njerën prej tyre.**
- c. Përmendni dhe komentoni dy revista të rëndësishme mode.**

## **Bibliografi**

- Ernst H. Gombrich, *Historia e Artit*, 1996.
- Rozela Dhimgjini, *Momente të Historisë së Artit nga Rilindja deri në shek. XX*, 2016.
- Ermir Hoxha, *Historia e Artit Shqiptar 1858- 2000*, 2019
- De Vecchi, Cerchiari, *Kohët e artit*, vëll. I, II.
- Andromaqi Gjergji , *Veshje popullore*, 1989.
- Album i veshjeve popullore shqiptare*, Instituti Kulturës Popullore, Vëll. I-V.
- Internet:** List of art movements.

## PYETJET PËR PROGRAMIN MULTIMEDIA:

### Teza 1

- a. Flisni për *Artin antik Grek* dhe për disa nga periudhat që e përbëjnë atë. Ndaloni më gjatë në njëren prej tyre.
- b. Flisni për piktorin *Abdurrahim Buza* dhe për tiparet e krijimtarisë së tij.
- c. Çfarë është *Video Art* dhe kur lindi ai. Flisni për një artist shqiptar që punon në mediumin e videos.

### Teza 2

- a. Flisni për *Kubizmin*. Kur lindi kjo rrymë artistike dhe cilët ishin protagonistët e saj?
- b. Përmendni disa artistë bashkohorë shqiptar. Flisni më gjatë për njërin prej tyre.
- c. Çfarë kuptoni me "*Art Konceptual*". Përmendni 2-3 shembuj, ku punohet me këtë mënyre artistike.

### Teza 3

- a. Flisni për artin në periudhën e *Barokut*. Përmendni dhe komentoni krijimtarinë e dy artistëve të kësaj periudhe.
- b. Flisni për veprën *Dea e Butrintit*. Ku u zbulua ajo dhe çfarë paraqet?
- c. Çfarë kuptoni me „*Land Art*“. Përmendni një artist të kësaj rryme dhe një punë të tij.

#### Teza 4

- a. *Flisni për piktorin holandez Van Gogh. Shpjegoni kohën kur ai jetoi dhe komentoni një nga veprat e tij.*
- b. *Flisni mbi një **fotograf të njohur bashkëkohor shqiptar**. Teknika dhe stili i tij artistik.*
- c. *Çfarë është videoinstalacioni? Përmendi një autor që përdor këtë medium në artin shqiptar.*

#### Teza 5

- a. *Flisni për Post impresionizmin dhe disa nga emrat kryesorë të kësaj rryme artistike. **Përmendni disa nga veprat e tyre dhe komentoni ato.***
- b. *Çfarë janë „**Kodikët**“. Përmendni disa „**Kodikë**“ shqiptarë dhe shpjegoni njërin prej tyre.*
- c. *Flisni për një ekspozitë të artit bashkohor. Shpjegoni veprat dhe teknikat që përdorin artistët në të.*

#### Teza 6

- a. *Kohëzgjatja dhe tipare të **Rilindjes Italiane**. Përmendni dhe komentoni dy vepra nga arkitektura apo arti i kësaj periudhe.*
- b. *“**Realizmi Socialist**” në Shqipëri. Tipare të kësaj rryme. Komentoni një vepër tipike të Realizmit Socialist Shqiptar.*
- c. *Shpjegoni termin “**Instalacion**”. Përmendni dhe trajtoni dy punë të kësaj forme artistike.*

### Teza 7

- a. Kush ishte Konstantin Brancusi. Shpjegoni tiparet e krijimtarisë së këtij artisti.
- b. Flisni mbi *ardhjen dhe zhvillimin e fotografisë në Shqipëri*.
- c. Çfarë kuptoni me termin "*Multimedia-s*"?

### Teza 8

- a. Kush ishte *Marsel Duchamp*. Cila është koha kur ai jetoi dhe pse ishte e rëndësishme krijimtaria e tij?
- b. Flisni mbi jetën dhe veprën e *Kol Idromenos*. Analizoni e komentoni pikturën e tij "*Motra Tone*".
- c. Shpjegoni rrymën artistike "*Dada*". Kushtet historike gjatë së cilës u zhvillua kjo rrymë, artistë dadaistë dhe punë të tyre.

### Teza 9

- a. Citoni rryma dhe *stile artistike të shek. XX*. Shpjegoni me gjerë njerën prej tyre si dhe dy vepra nga rryma e zgjedhur.
- b. Çfarë dini rreth fotografit *Gjon Mili*? Ku u zhvillua vepra e tij dhe çfarë risish kishte ajo për kohën?
- c. Citoni një artist bashkëkohor të famshëm sot në botë dhe shpjegoni stilin e punës së tij.



## Teza 10

- a. **Kush është autori i „Darkës së Fundit“.** Tipare të kësaj vepre dhe karakteristikat e kohës kur ai jetoi.
- b. **Citoni tre vepra të skulptorit *Odhise Paskali* dhe analizoni njerën prej tyre.**
- c. ***Performanc-ë*.** Çfarë kuptoni me këtë term artistik. Flisni më tepër mbi një artiste apo artist që punon në këtë formë.

## **Bibliografi**

- Ernst H. Gombrich, *Historia e Artit*, 1996.
- Rozela Dhimgjini, *Momente të Historisë së Artit nga Rilindja deri në shek. XX*, 2016.
- Ermir Hoxha, *Historia e Artit Shqiptar 1858- 2000*, 2019
- Zef Paci, *Marubi, objektivi i lëvizshëm i një arkivi*, 2014.
- Mark Tribe, Reena Jana, *New Media Art*, Taschen, 1998.
- Michael Lailach, *Land Art*, Taschen 2007.
- Daniel Marzona, *Conceptual Art*, Taschen 2005.
- Internet:** List of art movements.

## PYETJET PËR PROGRAMIN GRAFIKË:

### Teza 1

- a. Flisni për Artin antik *Grek* dhe përmendi disa nga periudha historike e artistike që përshkojnë atë.
- b. Flisno mbi piktorin shqiptarë pasbizantin Onufri. Çfarë e bën të rëndësishme veprën e këtij krijuesi?
- c. Cilat janë *Teknikat e Gravurës*. Përmendni dhe shpjegoni dy prej tyre.

### Teza 2

- a. Flisni për Albert Durer dhe krijimtarinë e tij në gravurë. Komentoni veprën e tij *Melankolia*.
- b. Cilët janë fotografët *Marubi*. Vlera e punës së tyre dhe kohën kur ato jetuan.
- c. Flisni për *artin e Posterit* në fund të shek. 19-të. Trajtoni një artist të këtij stili dhe shpjegoni teknikën e tij (Toulouse-Lautrec; Mucha etj.).

### Teza 3

- a. Flisni për piktorin Leonadro Da Vinci. Tipare të artit të tij. Përmendni dhe komentoni dy vepra nga krijimtaria e tij.
- b. *Amfiteatri i Durrësit*. Periudha e ndërtimit, historia e tij.
- c. Çfarë është *Dizajni Grafik*. Vlerat dhe përdorimi i tij.

#### Teza 4

- a. *Flisni për piktorin Diego Velaskes*. Flisni kohën kur ai jetoi dhe komentoni dy vepra nga krijimtaria e tij.
- b. Flisni mbi një *artist të njohur bashkëkohor shqiptar*. Teknika dhe stili i tij artistik.
- c. Përmendi disa *revista shqiptare* dhe komentoni dizajnin grafik të njërës prej tyre.

#### Teza 5

- a. Flisni për *Stilin Gotik*. Periudha kohore dhe tipare të këtij stili. Përmendni dhe komentoni dy vepra nga arkitektura e kësaj periudhe.
- b. Çfarë janë „*Kodikët*“. Përmendni disa „*Kodikë*“ shqiptarë dhe shpjegoni njërin prej tyre.
- c. *Gravura në shek. 15-të*. Artistë të gravurës së kësaj periudhe. Teknika dhe vlera e tyre, të shpjeguara në bazë të një shembulli.

#### Teza 6

- a. Kohëzgjatja dhe tipare të *Rilindjes Italiane*. Përmendni dhe komentoni dy vepra nga arkitektura apo arti i kësaj periudhe.
- b. „*Realizmi Socialist*“ në Shqipëri. Tipare të kësaj rryme. Komentoni një vepër tipike të Realizmit Socialist Shqiptar.
- c. *Presa e parë e shtypit* dhe shpikësi i saj. Libri i parë i shtypur. Vlerat e kësaj teknologjie.

## Teza 7

- a. Kush ishte “*Andy Warhol*. Flisni për këtë artist, stilin e punëve të tij dhe konceptin e ri artistik që ai sjell.
- b. Flisni mbi ardhjen dhe zhvillimin e *fotografisë në Shqipëri*.
- c. Flisni për një *ekspozitë grafike që keni parë*. Shpjegoni teknikat që pate aty dhe komentoni gjuhën artistike të tyre.

## Teza 8

- a. Flisni për skulptorin *August Roden*. Kur jetoi ai dhe cila ishte rëndësia e krijimtarisë së tij?
- b. Flisni mbi jetën dhe veprën e *Kol Idromenos*. Analizoni e komentoni pikturën e tij “*Motra Tone*”.
- c. Artistë shqiptarë bashkëkohorë që punojnë në formën e “*Dizajnit Grafik*”. Mediat që përdorin dhe punë të tyre.

## Teza 9

- a. Citoni rryma dhe *stile artistike të shek. XX*. Shpjegoni më gjerë njerën prej tyre si dhe dy vepra nga rryma e zgjedhur.
- b. Çfarë dini rreth piktorit *David Selenica*? Ku u zhvillua vepra e tij dhe çfarë risish kishte ajo për kohën?
- c. Citoni disa nga teknikat e grafikës. Shpjegoni më gjatë procesin e realizmit të njërës njërën prej tyre.

## Teza 10

a. Kush ishte piktori Klod Monet. Flisni për kohën kur ai jetoi dhe komentoni disa nga verat e tij.

b. Citoni tre vepra të skulptorit *Odhise Paskali* dhe analizoni njerën prej tyre.

c. *Käthe Kollëitz*. Flisni mbi këtë artiste dhe komentoni dy vepra të saj.

## Bibliografi

-Ernst H. Gombrich, *Historia e Artit*, 1996.

-Rozela Dhimgjini, *Momente të Historisë së Artit nga Rilindja deri në shek. XX*, 2016.

- Ermir Hoxha, *Historia e Artit Shqiptar 1858- 2000*, 2019

-Zef Paci, *Marubi, objektivi i lëvizshëm i një arkivi*, 2014.

-Internet: List of art movements.